



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200035/19

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim për ndarjen e procedimit penal të kallëzimit të paraqitur nga shtetasi A. H. nga procedimi penal nr. 182/2022 dhe hetimin më vete, nga prokurorë të ndryshëm.*

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË**

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me ankesën që ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit shtetasi A. H., i cili pretendon se është goditur në ballë nga me shotgun që hedh gaz lotsjellës nga një punonjës i Forcës së Ndërhyrjes së Shpejtë, gjatë protesës së datës 8 Janar 2022, të zhvilluar në godinën e zyrës qendrore dhe ambientet përreth selisë së subjektit politik Partia Demokratike.

Sipas deklarimeve që ky shtetas ka dhënë në media, ai është marrë në pyetje nga një oficer i policisë gjyqësore në mjediset e Spitalit Universitar të Traumës ku është dërguar me autoambulancë për t'u trajtuar për shkak të lëndimeve të shkaktuara. Pas marrjes së mjekimit në këtë spital, ai është marrë në pyetje nga një punonjës i policisë. Në vijim, është shoqëruar në ambientet e policisë, ku është marrë në pyetje nga një tjetër oficer i policisë gjyqësore.

Për verifikimin e kësaj ankese jemi interesuar më parë në Komisarlatin e Policisë Nr.1, Tiranë. Në përgjigjen që kemi marrë nga ky Komisarlat jemi vënë në dijeni se shtetasi A. H. i janë marrë deklarime në datën 08.01.2022, në mjediset e Spitalit Universitar të Traumës. Meqenëse ky shtetas ka pretenduar se është goditur në ballë nga municion i lëshuar me shotgun nga punonjës të Forcës së Ndërhyrjes së Shpejtë, atij i është dhënë vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, një kopje e së cilës i është dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe një kopje institucionit të propurorisë, bashkë me materiale të tjera për hetimin e kësaj ngjarjeje. Pas verifikimit të pamjeve filmike të protestës së zhvilluar nuk ka rezultuar që shtetasi A. H. të jetë përfshirë në akte të dhunshme, e në këto rrethana ai është lënë i lirë nga Komisarlati po në datën 08.01.2022. Po ashtu, në këtë përgjigje informohemi se të gjithë materialet i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën Nr. 114-k Prot., datë 09.01.2022

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, shtetasi A. H. na ka vënë në dijeni se i është drejtuar institucionit tuaj me një kallëzim në datën 08.02.2022 që lidhet me këtë ngjarje, pra goditjen me shotgun që hedh gaz lotsjellës nga punonjësi i FNSH-së si dhe pretendimin se mjekja e Spitalit Ushtarak Tiranë, shtetësja E. G. ka paraqitur të dhëna të rreme mbi mënyrën si ai është dëmtuar në datën 08.01.2022, me qëllim që të përkrahë autorët e ngjarjes.

Nga ana jonë është administruar akti i dëshmisë mjeko-ligjore Nr. 16/D, datë 14.01.2022 “*Mbi ekzaminimin e shtetasis A. H.*”, ku nga këqyrja objektive e këtij shtetasi ka rezultuar si vijon:

“Në momentin e ekzaminimit, gjendja e përgjithshme paraqitet relativisht e mirë. Ankon për dhimbje koke, marrje mendsh, vështirësi në shikim, dobësi trupore. Lokalisht konstatohet në regjionin frontal, pak mbi hapsirës ndërmjet dy vetullave, një garzë spitalore e fiksuar me ngjitës ngjyrë blu të hapur pas heqjes të së cilës konstatohet një plagë shqyese shtypëse në trajtë të çrregullt, e përpunuar me 5 (pesë) sutura, në ngjyrë të kuqerremtë, shoqëruar me edemë të indeve të buta përreth saj. Në gropat e të dy syve vihen re ekimoza në ngjyrë mavi e çelur, periorbitale bilaterale, me shtrirje në kapakët e sipërm dhe të poshtëm të syve shoqëruar me edemë të shprehur të indeve të buta në këtë regjion. Dëmtime të tjera të jashtme trupore nuk u vërejtën”.

Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme, mjeku ligjor ka arritur në përfundimin se:

- Tek shtetasi A. H. konstatohen shembje të indeve të buta të fytyrës, ekimoza si dhe plagë shqyese shtypëse me lokalizimin dhe karakteristikat e përshkruara më lart.

- Këto dëmtime janë shkaktuar me mjete të forta mbretëse.
- Dëmtimet e mësipërme hyjnë në kategorinë e dëmtimeve, të cilat japin si pasojë humbje të aftësisë së përkohëshme për punë në masën mbi 9 (nëntë) ditë.

Në vijim të hetimit tonë administrativ, iu drejtuam institucionit tuaj me shkresa të përsëritura¹ për t'u informuar nëse ishte regjistruar procedim penal dhe në çfarë faze ndodhej hetimi lidhur me pretendimet e shtetasit A. H. se ai është goditur në ballë nga municioni i lëshuar me shotgun nga një punonjës i Forcës së Ndërhyrjes së Shpejtë dhe se mjekja e Spitalit Ushtarak Tiranë znj.E. G. ka paraqitur të dhëna të rreme mbi mënyrën si është dëmtuar në datën 08.01.2022.

Në përgjigjen tuaj, ardhur me shkresën Nr.16870/1 Prot., datë 06.12.2022, vihemi në dijeni se materiali kallëzues i shtetasit A. H. ndaj shtetases E. G. dhe FNSH-së, është bashkuar me materialin procedural në lidhje me protestën e datës 08.01.2022. Për çështjen që ka të bëjë me protestën e datës 08.01.2022 është regjistruar procedimi penal nr.182/2022, për nenet 150 (shkatërrimi i pronës), 274 (prishja e qetësisë publike), 278 (Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit) dhe 279 (Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta) të Kodit Penal. Kjo çështje është ende në fazën e hetimeve.

Referuar Kodit të Procedurës Penale, rastet e bashkimit të procedimeve përcaktohen në nenin 79 të tij. Më konkretisht, organi procedues mund të vendosë bashkimin e procedimeve:

a) kur vepra penale për të cilën zhvillohet procedimi është kryer nga disa persona në bashkëpunim ndërmjet tyre ose kur disa persona në mënyrë të pavarur kanë shkaktuar veprën;

b) kur një person akuzohet për disa vepra penale;

c) kur një person akuzohet për disa vepra, nga të cilat një pjesë janë kryer për të realizuar ose për të mbuluar të tjerat ose për t'i siguruar fajtorit apo të tjerëve përfitime të paligjshme ose mosdënimin.

Në përgjigjen tuaj dërguar institucionit tonë, evidentojmë se nuk janë sqaruar se cilat janë rrethanat apo argumentet që kanë çuar organin e prokurorisë në marrjen e vendimit për bashkimin e materialit procedural të kallëzimit të shtetasit A. H. me materialin procedural që ka të bëjë me veprimet e dhunshme të kryera gjatë protestës së datës 08.01.2022. Për më tepër, referuar informacionit të dhënë nga

¹ Shkresat me: Nr.K2/A2-8 Prot., datë 01.02.2022; Nr.K2/A2-12 Prot., datë 02.04.2022; Nr.K2/A2-14 Prot., datë 14.06.2022; Nr.K2/A2-15 Prot., datë 02.09.2022; Nr.K2/A2-16 Prot., datë 12.10.2022; Nr.K2/A2-17 Prot., datë 22.11.2022.

Komisariati i Policisë Nr.1, nga shpjegimet e këtij shtetasi mbi rrethanat e ngjarjes si dhe nga verifikimi i pamjeve filmike gjatë zhvillimit të protestës, nuk ka rezultuar që ai të jetë përfshirë në veprime të dhunshme.

Edhe më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit janë trajtuar raste në të cilat nga organet kompetente të prokurorisë janë administruar kallëzime nga personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime apo prokurorët e çështjes kanë filluar kryesisht procedimin penal në rastet e ankesave të paraqitura në seancat gjyqësore nga të dëmtuarit. Por, në vijim të veprimeve, procedimet penale janë bashkuar në të njëjtin procedim dhe hetimet janë ndjekur nga i njëjti prokuror.

Kjo problematikë është trajtuar nga ana jone dhe është bërë objekt i disa rekomandimeve të cilat u janë dërguar organeve respektive të prokurorisë. Por, evidentojmë se ky qëndrim është i përsëritur. Në këto rrethana, çmojmë me vend të sjellim në vëmendje Raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (më poshtë CPT), që është bërë publik, në datën 17.09.2019 mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018². Një pjesë e raportit i dedikohet Policisë së Shtetit dhe prokurorisë, ku parashtrohen konstatime dhe rekomandime mbi hetimin e ankesave për ushtrim dhune dhe keqtrajtim. Disa nga rekomandimet që kanë të bëjnë me parandalimin e keqtrajtimit, përdorimin e forcës dhe hetimin e ankesave ndaj Policisë së Shtetit, janë si më poshtë:

A. Ndalimi nga Policia

2. Keqtrajtimi

14. Është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjës të policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.

Oficerët e policisë gjithashtu duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është e nevojshme kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk

² Për më tepër shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.

15. Përbërës thelbësor i çdo strategjie për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cënuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

16. Nga konsultimet që delegacioni zhvilloi me prokurorin e rrethit përgjegjës për rastet e keqtrajtimin të referuar nga IEVP 313, është vënë në dijeni se korrespondenca e dërguar nga burgu ishte bashkuar me dosjen përkatëse të hetimit penal lidhur me kallëzimet ndaj personave në fjalë, pa u kryer ndonjë veprim hetimor në lidhje me pretendimet e keqtrajtimin (siç është marrja e një deklaratë ose kërkimi i një ekzaminimi mjeko-ligjor). Kur u pyet për një shpjegim në lidhje me këtë gjendje, prokurori u shpreh se, sipas mendimit të tij, nuk kishte pasur prova të pamjaftueshme për të hapur një hetim penal për pretendimet e keqtrajtimin të policisë.

Sipas mendimit të CPT, mungesa totale e veprimit hetimor nga prokurori në dritën e pretendimeve konkrete për keqtrajtim të policisë, të cilat u mbështetën edhe me prova mjekësore (nga burgu), është e pajustificuar.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ofruar trajnime për prokurorët përkatës në mënyrë që të sigurohet:

- Ankesat dhe informacionet e tjera për keqtrajtime të policisë të hetohen në mënyrë efektive;

- Sa herë që prokurorët të marrin ankesa ose informacione të tjera treguese për keqtrajtim të policisë, të urdhërohet menjëherë një ekzaminim mjeko-ligjor.

17. Në përgjithësi, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve për keqtrajtim të policisë i kishte kaluar të njëjtit prokuror që ishte përgjegjës për hetimin penal kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar. Sipas prokurorit, i cili u takua nga delegacioni, kjo ishte praktikë normale në sistemin gjyqësor shqiptar.

Sipas mendimit të CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund të çënojë paanshmërinë e prokurorit në fjalë. Prandaj, **Komiteti rekomandon që rastet e keqtrajtimin të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara.**

Sipas informacioneve tona, ky raport është përcjellë në institucionet tuaja me letërporosi që në vitin 2020³, dhe vlerësojmë se duhet të kishte një reflektim pozitiv në vijimësi në zbatimin e rekomandimeve përkatëse për të garantuar të drejtat e kallëzuesit/viktimës gjatë procesit penal.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, vlerëson se, bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, si dhe për të garantuar respektimin me korrektesë, objektivitet, paanshmëri e profesionalizëm të rregullave dhe parimeve procedurale gjatë hetimit të procedimit penal, domosdoshmërisht lind nevoja e një reagimi nga organi juaj për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve gjatë procesit penal në përputhje me legjislacionin procedural penal në fuqi dhe rekomandimet e CPT-së. Këtë vlerësim e mbështesim edhe duke iu referuar nenit 1 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: *“Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.”*

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës së organit të prokurorisë në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË :

Marrjen e masave të nevojshme për ndarjen e procedimit penal të kallëzimit të paraqitur nga shtetasi A. H. nga procedimi penal nr. 182/2022 dhe hetimin më vete, nga prokurorë të ndryshëm.

³ Për më tepër, shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020). Përgjigjja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “*Për Avokatin e Popullit*”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi